



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.06.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Albana Vokshi – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me ministren e Kulturës, zonjën Mirela Kumbaro, për informacion dhe shpjegime të mëtijshme në lidhje me projektligjin “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt projektimin dhe realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar” me prezencën e një grupi artistësh *(me kërkesë të një grupi deputetësh)*

Marrin pjesë:

Albana Vokshi, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Nora Malaj, Kejdi Mehmetaj, Besnik Baraj (zëvendësues), Ilir Beqaj (zëvendësues), Anduel Xhindi (zëvendësues), Endri Hasa (zëvendësues) dhe deputetë të tjerë të grupit parlamentar të PD.

Mungojnë:

Ismet Beqiraj, Fatmir Velaj.

Të ftuar:

Mirela Kumbaro – Ministre e Kulturës,

Valbona Shujaku – Zëvendësministre e Kulturës,

Oltjon Muzaka – sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës,

Sofjan Jaupar – këshilltar Ligjor i Ministres së Kulturës,

Daniel Pirushi – këshilltare e Ministres së Kulturës,

Përfaqësues të artistëve të Teatrit Kombëtar:

Stefan Çapaliku, Altin Basha, Arben Derhemi, Taulanda Jupi, Alida Karakushi, Robert Budina.

Prezent: Kryetari i Bashkisë së Tiranës, z. Erion Veliaj.

HAPET MBLEDHJA

Albana Vokshi – Mirëmëngjesi!

Sikurse ju kemi njoftuar, sot Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, pas një kërkesë të bërë nga deputetët e opozitës, ka kërkuar seancë dëgjimore me ministren e Kulturës, zonjën Mirela Kumbaro, për informacion dhe shpjegime të mëtejshme në lidhje me projektligjin “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt projektimin dhe realizimin e projektit urban dhe të godinës së re të Teatrit Kombëtar”, si dhe të gjitha çështjet e tjera që kanë të bëjnë me Teatrin Kombëtar, me prishjen apo jo të tij dhe me këtë projektligj, që ju, si ministri, e keni vendosur në portalin *konsultimipublik.gov.al* para disa ditësh.

Dua t’ju informoj se kërkesa për këtë dëgjese është bërë sipas nenit 34 të Rregullores, ku një grup prej 1/3 të deputetëve të një komisioni ka të drejtë që të thërrasë krerët e institucioneve për të dhënë llogari për implementimin e ligjeve, për draftligjet apo për çështje të tjera në përgjegjësi të atij institucioni.

Gjithashtu, dua t’ju informoj se me një kërkesë tjetër, po e 1/3-ta e deputetëve të komisionit, ka kërkuar dëgjese me kryetarin e bashkisë, zotin Erion Veliaj, jo sot, por nesër, pra në datën 20 qershor, jo për të folur për projektligjin, por për të folur për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me truallin publik, i cili është në varësi të bashkisë, dhe me projektin që është dorëzuar apo projektin që një kompani e caktuar, pra kompania “Fusha” ka dorëzuar për zhvillimin e zonës mbi Teatrin dhe rreth Teatrit Kombëtar.

Në mbledhjen e djeshme deputetët e maxhorancës kanë bërë një kërkesë mbi kërkesë, unë nuk e di ku e gjejnë bazën ligjore, sepse as në Rregullore nuk është parashikuar asgjë, ku thonë: “Ne pranojmë, por që të vijë edhe kryetari i bashkisë në një dëgjese të përbashkët”. Unë nuk e di pse ministrja e Kulturës ka frikë që të përballlet me shpjegimin e një projektligji, të cilin ajo e ka përgjegjësinë për ta konsultuar dhe për ta ndjekur mbarëvajtjen e miratimit apo mendimit, apo miratimit në fund të ditës, apo jo, të këtij projektligji, sepse nuk e kuptoj pse gjithmonë Rama vendos t’ju çoj çift ju të dyve, kudo që shkoni, të shkoni çift. Tani, ose ju nuk

keni aftësinë për të mbrojtur një projektligj, ose nuk doni ta mbronin këtë projektligj dhe unë shpresoj të jetë kjo e dyta, sepse, në fund të fundit, sot ka ende njerëz me ndërgjegje, që edhe mund të tërhiqen nga akte të tilla, të cilat janë flagrante, korruptive dhe pazare që ju po ju bënë që t'i ligjëroni. Ndaj, ne nuk pranuan kërkesën e deputetëve të Partisë Socialiste dhe vendosëm që të vazhdonim ashtu siç e ka të përcaktuar Rregullorja. Nuk u hodh as në votim. Ndaj e përcaktuar në kalendarin e komisionit sot ishte vetëm dëgjesa me ministren, sepse kështu e kemi kërkuar dhe kështu duhet bërë. Çështjet që kemi për të diskutuar me ministren Kumbaro, nuk janë çështjet që ne donim të sqaronim, në mënyrë të shteruar, me kryetarin e bashkisë. Ndaj, edhe e mënyra arrogante e ardhjes së kryetarit të bashkisë, që siç duket mendon se është zot në Tiranë, pavarësisht se nuk është votuar për këtë gjë, mua më duket krejt e papërshtatshme dhe e papranueshme, sepse ne nuk kishim vendosur që ju sot do të ishit këtu. Minimalisht duhet të bëni një komunikim. Mbrëmë, edhe në orët e fundit të darkës, mund të kishit bërë një komunikim.

Jo është dërguar një *e-mail*, që tregonte vetëm dy përfaqësues nga bashkia dhe jo ju, zoti Veliaj, dhe unë kam thënë: “Zoti Veliaj, është të mërkurën në dëgjese”, këtë mund t’ju shpjegojë dhe nënkryetarja.

Erion Veliaj – Unë thashë se nuk jam nesër, tani po bën teatër kot. Kjo është e gjitha një iniciativë për të bërë ju teatër. Në vend që të bëjnë aktorët teatër, po bëni ju.

Albana Vokshi – Zoti Veliaj, po bëni zhurmuesin atje...

Erion Veliaj – Unë sapo ju thashë se nesër sheshi “Skënderbej” është për një çmim në Barcelonë dhe për respekt erdha, ashtu siç më kërkuat.

Albana Vokshi – Zoti Veliaj, a mund ta mbyllni mikrofonin, sepse nuk e merrni dot mikrofonin këtu në parlament, kur nuk ua jep njeri.

Erion Veliaj – Sheshin “Skënderbej”, të cilin e luftuat....

Albana Vokshi – Ju lutem, mbyllni mikrofonin!

Erion Veliaj – Sepse po gënjen!

Albana Vokshi – Ti nuk më thua dot se po gënjej dhe mos u trego arrogant as me mua, as me deputetët, që kanë kërkuar dëgjese me ministren.

Erion Veliaj – Ti po gënjen, siç po gënjeni për Teatrin, siç po gënjeni për aktorët dhe siç po bëni teatër. Nesër, me sheshin “Skënderbej”, do të shikoni se çdo projekt që ju e kundërshtoni kështu, bota e vlerëson.

Albana Vokshi – Zoti Veliaj, mund të qëndroni më lart se kaq. Mbylleni mikrofonin! Zoti Veliaj, nuk jua kam dhënë fjalën.

Erion Veliaj – Sapo të thashë. Ki dinjitetin të thuash të vërtetën. Dinjiteti kërkon që të thuash të vërtetën. Ti nuk mund të gënjesh. Nëse do të bësh aktoren, shko bëj audicion, por këtu nuk mund të gënjesh.

Albana Vokshi – Së pari, ki kujdes me gjuhën që përdor.

Erion Veliaj – E di fare mirë, më ke ftuar kur, nuk të takon të më ftosh, sepse nuk më ka zgjedhur parlamenti.

Albana Vokshi – Unë jam kryetare e komisionit, prandaj ki kujdes me gjuhën që përdor, sepse ju

Erion Veliaj – Nuk më ka zgjedhur parlamenti. Kur të më zgjedhë parlamenti, do të vij të përgjigjem, por erdha për respekt. Të vjen tjetri për respekt dhe ti i thua “ik”! Çfarë do të thotë kjo?

Albana Vokshi – Unë nuk dua respekt.

Erion Veliaj – Ke frikë?! Nëse ke frikë...

Albana Vokshi – Ti duhet të zbatosh ligjin dhe Rregulloren.

Erion Veliaj – Ti ndoshta nuk meriton respekt, por unë do ta jap, sepse je qytetare e këtij qyteti.

Albana Vokshi – Mbledhjen këtu e drejtoj unë, nuk e drejtoni ju.

Erion Veliaj – Më ftuat, erdha edhe pse nuk mund të më ftoni, sepse nuk më ka zgjedhur parlamenti. Erdha me kënaqësi, kurse tani më thoni “çohuni dhe ikni”. Kjo që po bën është fyerje e inteligjencës.

Albana Vokshi -...Nëse ti ke ardhur këtu për të bërë rolin e zhurmuesit, mua më vjen shumë keq për juve! Më vjen shumë keq, nëse ke ardhur këtu për të bërë rolin e zhurmuesit!

Erion Veliaj – Siç bëtë me këndin e lodrave, siç bëtë me Pazarin e Ri, siç bëtë me sheshin “Skënderbej”, siç bëtë me bulevardin. Ju shfrytëzoni çdo kauzë për pikë politike. E humbisni kauzën dhe shkoni me bisht ndër shalë...

Albana Vokshi - Unë mund t’ju nxjerr...

Erion Veliaj – ... projektet bëhen, Tirana fiton dhe ju përsëri bëni të njëjtin gabim, si te lodrat, ashtu edhe me Teatrin, bëni të njëjtën tragjedi.

Albana Vokshi - Zoti kryetar, jeni bërë për të ardhur keq!

Erion Veliaj – Sollët Bujar Nishanin te lodrat, bllokuat Pazarin e Ri, bllokuat Liqenin, bllokuat sheshin “Skënderbej”. Ja ku jemi sot. Tirana është sot më e suksesshme në të gjitha projektet që keni kundërshtuar. Kjo është fyese!

Albana Vokshi - Zoti Veliaj, unë mund t’ju nxjerr edhe jashtë. Unë mund t’ju nxjerr jashtë nga kjo mbledhje.

Erion Veliaj – Jo, moj, jo, ti kurrë nuk e bën, këtë harroje...

Albana Vokshi – Sepse ju jeni i paftuar...

Erion Veliaj – Iku koha kur ju nxirrnit jashtë njerëz.

Albana Vokshi – Jeni i paftuar. Unë mund t’ju nxjerr jashtë.

Erion Veliaj – Të lutem! Nëse do të bëhesh aktore, shko për audicion.

Albana Vokshi – Mbylleni mikrofonin, ju lutem, se nuk jua kam dhënë fjalën!

Erion Veliaj – Më ftove në dëgjesë, të lutem!

Albana Vokshi – Nuk të kam ftuar. Ke ardhur i paftuar sot.

Erion Veliaj – Sapo the që më ftove në dëgjesë.

Albana Vokshi – Ke ardhur i paftuar, sepse nuk doni të lini ministren vetëm!

Erion Veliaj – Më ftove në dëgjesë dhe ke frikë të dëgjosh të vërtetat...

Albana Vokshi – Keni ardhur për të bërë zhurmuesin.

Erion Veliaj – ...sepse teatri do të jetë njësoj si Pazari, do të jetë njësoj si këndi i lojërave...

Albana Vokshi – Nëse ne dhe artistët do t’ju lëmë, por nuk bëni dot!

Erion Veliaj – Çdo gjë që ju sulmoni, bëhet edhe më e bukur.

Albana Vokshi – A ka mundësi ta mbyllësh?

Erion Veliaj – Artistët...

Albana Vokshi – Zoti Veliaj...

Erion Veliaj – Dje ishte vetëm PD-ja aty. Ku ishin artistët?

Albana Vokshi – Zoti Veliaj, mos merrni kot! Mbylleni mikrofonin!

Erion Veliaj – Dje ishte vetëm PD-ja dhe...

Albana Vokshi – Mos merrni kot! Mbylleni mikrofonin!

Erion Veliaj – Të lutem, këtu mos gënje!

Albana Vokshi – Më fal, këtu jam unë kryetare, s’jeni ju!

Erion Veliaj – Je kryetare, por nuk je kryegënjeshitare.

Albana Vokshi – Këtu jam unë kryetare, nuk jeni ju.

Erion Veliaj – Je kryetare, por jo kryegënjeshitare dhe mos gënje...

Albana Vokshi – Ju nuk vendosni.

Erion Veliaj – Zonjë, mos gënje, më ftove të vija. Të thashë që nesër merr çmim sheshi “Skënderbej” dhe nuk mund të jem nesër. Tani erdha për të të respektuar...

(Deputetët flasin njëkohësisht.)

Albana Vokshi – Mos bëni zhurmë kot!

Erion Veliaj – Nuk më ka zgjedhur parlamenti. Pse nuk vijnë kryetarët e tjerë të bashkive?! Sepse e dinë që nuk i ka zgjedhur parlamenti. Ju thërrisni këtu trupa të zgjedhur nga parlamenti...

Albana Vokshi – Zoti Veliaj, mbylleni mikrofonin! Mbylleni mikrofonin, ju lutem! Mbylleni mikrofonin!

Erion Veliaj – Ti do të qetësohesh dhe do të kuptosh se çdo sulm...

Albana Vokshi – Po lëri, more, këto!

Erion Veliaj – ...që i keni bërë këtij qyteti, projekti ka dalë më i bukur.

Albana Vokshi – Këtë bëje me ato që ke zgjedhur në bashki. Të lutem, mbylle mikrofonin!

Erion Veliaj – Çdo sulm që i keni bërë Tiranës... Çuat Presidentin e Republikës...

Albana Vokshi – Këtu drejtoj unë, nuk drejtoni ju...

Erion Veliaj – Çuat Presidentin e Republikës te lodrat... Shikojini lodrat sot!

Të gjithë deputetët e PD-së i kanë kalamajtë te lodrat.

Albana Vokshi – Mbylle mikrofonin!

Milva Ekonomi – Në fakt, ke të drejtë, Erion, sepse ne të thirrëm në mbledhje, maxhoranca të thirri në mbledhje...

Erion Veliaj – Më fal, shiko Pazarin e Ri! Të gjithë deputetët e PD-së i ke për kafe të Pazari i Ri...

Albana Vokshi – Për çfarë ke ardhur?!

Erion Veliaj – Shiko sheshin “Skënderbej”...

Albana Vokshi – Për çfarë ke ardhur?

Erion Veliaj – Të gjithë deputetët i ke te sheshi “Skënderbej”.

Albana Vokshi – Për çfarë ke ardhur? Po bën figurë shumë të keqe...

Erion Veliaj – Jo, ajo që po them...

Albana Vokshi – Po bën figurë shumë të keqe...

Erion Veliaj – Ajo që po të them është, ke pasion...

Albana Vokshi – A e kupton që je kryetar bashkie?! Qëndro në nivelin e një kryetari bashkie...

Erion Veliaj – Qetësohu, qetësohu një sekondë! Ke pasion të bëhesh aktore, por dështove si aktore dhe ke sjellë teatrin në parlament. Shkon dhe u vjedh protestën atyre dhe jeni diskredituar tek aktorët, sepse njerëzit e kanë kuptuar që ju i suleni çdo projekti publik....

Albana Vokshi – Qëndro në nivelin e një kryetari bashkie!

Erion Veliaj – Projekti publik që ju i suleni, del më i bukur!

Albana Vokshi – Ju këtu, zoti kryetar, nuk vini dot.

Erion Veliaj – Erdha të të respektoj.

Albana Vokshi – Jo, nuk vini dot.

Erion Veliaj – Ti nuk e meriton, por unë erdha të të respektoj për institucionin...

Albana Vokshi – Se çfarë meritoj unë, nuk e di ti.

Erion Veliaj – E di, pra, e di. E pashë edhe te votat.

Albana Vokshi – Nuk e di ti, por ata që më kanë votuar se çfarë meritoj unë.

Erion Veliaj – E pashë, e pashë... Tek të gjitha projektet që ju sulmoni...

Albana Vokshi – Se çfarë meriton ti, do ta shohësh shumë shpejt. Tani, a mund ta fikësh?

Erion Veliaj – Të gjitha projektet që sulmoni... Qetësohu një sekondë!

Albana Vokshi – Këtu jam unë dhe jo ju.

Erion Veliaj – Qetësohu një sekondë! Qetësohu! Qetësohu!

Albana Vokshi – Mos bëj arrogantin kot, se nuk e bën dot këtu!

Erion Veliaj – Të gjitha projektet që ju sulmoni...

Albana Vokshi – Këtu nuk e bën dot arrogantin...

Erion Veliaj – Më dëgjo me vëmendje!

Albana Vokshi – Fike, se ka një rend dite, bazuar në Rregullore...

Erion Veliaj – Të gjitha projektet që ju sulmoni...

Albana Vokshi – Fike mikrofonin! Fike mikrofonin, se me mua nuk ia del dot!

Erion Veliaj – Qetësohu një sekondë!

Albana Vokshi – Nuk ia del dot me mua.

Erion Veliaj – Jo, jo, me ty nuk ia del dot e gjithë PD-ja për atë punë, por...

Albana Vokshi – Fike mikrofonin! Mos bëj zhurmuesin!

Erion Veliaj – Të gjitha projektet që ju sulmoni, dalin më të bukura.

Albana Vokshi – Qëndro në nivelin e një kryetari bashkie!

Erion Veliaj – Pazari i Ri doli më i bukur pas sulmit.

Albana Vokshi –Mos u trego arrogant!

Erion Veliaj – Lodrat dolën më të bukura pas sulmit.

Albana Vokshi – Ti nuk do të flasësh, pa ta dhënë unë fjalën.

Erion Veliaj – Sheshi “Skënderbej” doli më i bukur pas sulmit.

Albana Vokshi – Harroje këtu!

Erion Veliaj – Bulevardi i ri doli më i bukur pas sulmit. Çdo gjë që ju sulmoni, del më e bukur.

Albana Vokshi – Zoti Kryetar, zoti kryetar...

Erion Veliaj – Sulmojeni edhe teatrin, se do të dalë edhe më i bukur. Mbaje mend këtë!

Albana Vokshi – Zoti kryetar, fike mikrofonin!

Erion Veliaj – Mbaje mend! Sulmojeni dhe do të dalë më i bukur...

Albana Vokshi – Fike mikrofonin! Fike mikrofonin, se do të nxjerr përjashta!

Erion Veliaj – Atë përjashta, e harron ti, po...

Albana Vokshi – Fike, se do të të nxjerr përjashta...

Erion Veliaj – Atë përjashta...

Albana Vokshi – Je i paftuar...

Milva Ekonomi – Absolutisht nuk e nxjerr dot jashtë ti...

Erion Veliaj – Atë e harron...

Albana Vokshi – Unë jam këtu për të të shpjeguar Rregulloren...

(Deputetët flasin njëkohësisht.)

Erion Veliaj – Jo, më ule që të gënjesh...

Albana Vokshi – Ju shkelni Rregulloren, ligjet, Kushtetutën, por jo këtu, ku drejtoj unë...

Erion Veliaj – Më ule që të gënjesh.

Milva Ekonomi – A mund ta marr unë fjalën për procedurë!

Albana Vokshi – ...dhe jo për kërkesën që bëjnë deputetët e PD-së...

Erion Veliaj – Gënjeve në sy të të gjithëve. Më ke çuar ftesë.

Milva Ekonomi – Kërkesën e kemi bërë ne, me shumicën e firmave të komisionit.

Erion Veliaj – Ta sqarova se nuk jam nesër.

Albana Vokshi – Ta kemi çuar për të mërkurën.

Erion Veliaj – Erdha me kolegët e bashkisë. Pra, paska qenë Ok-ej të vijnë kolegët e bashkisë, por jo kryetari i bashkisë!

Albana Vokshi – Të kam ftuar të mërkurën. Ti je kryetar bashkie, por nuk vendos këtu.

Erion Veliaj – Të lutem! Çdo gjë që ju e keni sulmuar, ka dalë më e bukur...

Sa më shumë e sulmoni teatrin, më i bukur do të dalë nesër.

Albana Vokshi – Do ta sqarojmë nesër. Sot do ta sqarojmë me ministren e Kulturës dhe jo më ju...

Erion Veliaj – Të thashë që nesër nuk jam dhe gënjen.

Albana Vokshi – Atëherë, hesht, mbylle mikrofonin, se e ka ministria e Kulturës!

Erion Veliaj – Sapo të kam thënë...

Milva Ekonomi – E mora unë fjalën për procedurë...

Albana Vokshi – Nëse ju doni të dëgjoni, unë po ju lejoj që të rrini...

Erion Veliaj – Ndërkohë, një e treta e grupit...

Milva Ekonomi – E kërkoja unë fjalën për procedurë...

Albana Vokshi – Ta mbyllë ai njëherë. Ti nuk e merr fjalën për procedurë. Mbylle...

Erion Veliaj – Që nuk është vetëm një e treta juaj, sepse grupi ka tre të treta, që të të shpjegoj një aritmetikë të thjeshtë, një e treta tjetër...

Albana Vokshi – Ti më shpjegon mua aritmetikën?!

Erion Veliaj – Patjetër, se nuk e di një të tretën.

Albana Vokshi – Në cilën shkollë? Në cilën shkollë e ke bërë?

Erion Veliaj – Më fton dhe thotë: “nëse nuk mund të vish nesër, eja sot..”

Albana Vokshi – Me cilën shkollë? Me atë që ke bërë aritmetikën e tjetërsimit të pronës?

Erion Veliaj – E kam bërë shkollën në Amerikë; e kam bërë shkollën në Angli...

Albana Vokshi – Mbylle...

Erion Veliaj – Te shkolla “Kosova”, te “20 dhjetori”, te “Sami Frashri”, ku të duash kam bërë aritmetikë...

Albana Vokshi – I di, i di...

Erion Veliaj – Por di të them këtë: çdo projekt që ju keni sulmuar, ka dalë më i bukur...

Albana Vokshi – Mbylle mikrofonin tani! Mos u trego arrogant, por respekto deputetët...

Erion Veliaj – Sulmojeni teatrin, se do të dalë më i bukur...

Albana Vokshi – Respekto deputetët që kanë kërkuar....

Erion Veliaj – Siç sulmove lodrat, dolën më të bukura...

Albana Vokshi – Respekto ministren. Mbylle!

Erion Veliaj – Siç sulmove sheshin, doli më i bukur. Siç sulmove pazarin, doli më i bukur.

Albana Vokshi – Mbylle!

Erion Veliaj – Sulmojeni, se do të dalë më i bukur, sepse çdo gjë që ju bëni, diskrediton kauzën!

Albana Vokshi – Mbylle mikrofonin, zoti kryetar!

Erion Veliaj – Ua vidhni kauzën sindikatave...

Albana Vokshi – Mbylle mikrofonin, se do të urdhëroj t’ju nxjerrin! Nëse do të rrini të dëgjoni...

Erion Veliaj – Partia Demokratike u themelua te Rruga e Kavajës...

Albana Vokshi – Nuk të lë ai, thuaj të heshtë...

Erion Veliaj – Nuk i doli dhe nuk tha njeri është seli historike, por thanë: nga Rruga e Kavajës, shkojmë në qendër të Tiranës...

Albana Vokshi – Nuk të dalin 24 orë me mashtrimet e tua të bësh reklamë?!

Erion Veliaj – Vajti PD-ja aty ku është Toptani.

Albana Vokshi – Mbylle tani!

Erion Veliaj – Nuk ju doli dhe s’ tha njeri që është historike. Thanë që PD-ja ka nevojë të rritet.

Albana Vokshi – Mbylle! Zoti Veliaj...

Erion Veliaj – Vajti mori SHQUP-in, e rikonstruktoi dhe ta gëzojë

Albana Vokshi – Zoti Veliaj, mbylle!

Erion Veliaj – Por vetë historia e partisë suaj është që ju selitë historike nuk i ruani...

Albana Vokshi – Mbylle, se do të thërras oficerët t’ju nxjerrin përjashta!

Erion Veliaj – Selitë historike ju i zgjeroni...

Albana Vokshi – Do të thërras oficerët t’ju nxjerrin përjashta!

Erion Veliaj – Me të drejtë, se keni nevoja, doni zyra...

Pra, Partia Demokratike ndërron tri seli, asnjëri nuk thotë që është historike. Akomodoheni vetë dhe thoni: për ne është mirë zgjerimi, fuqizimi dhe lartësimi, kurse artistët le të rrinë me minj dhe me mace...

Albana Vokshi – Atëherë, ndërpritet mbledhja e komisionit derisa kryetari i bashkisë të ikë...

Erion Veliaj – Artistët i fyeni...

Albana Vokshi – Ndërpritet mbledhja e komisionit! Media përjashta!

(Largohen artistët e ftuar në Komision.)

Milva Ekonomi – Nuk e vendos dot ti atë.

Albana Vokshi – E vendos unë se kur mbyllet.

Erion Veliaj – Artistëve u thoni: rrinë në depo...

Milva Ekonomi – Nuk e vendos dot ti atë. Hidhe në votë!

(Deputetët flasin njëkohësisht.)

Milva Ekonomi – Mos e ndërprit mbledhjen e komisionit!

Erion Veliaj – Regjistrohu në PD...

Albana Vokshi – Media të dalë përjashta!

Erion Veliaj – Jo, kamerat të rrinë këtu!

Milva Ekonomi – Hidhe në votë rendin e ditës! Mos e ndërprit mbledhjen e komisionit!

Albana Vokshi – Zotërinj oficerë...

(Deputetët flasin njëkohësisht.)

Erion Veliaj – Kamerat le të rrinë.

Milva Ekonomi – Hidh në votë rendin e ditës!

Erion Veliaj – Meqë PD-ja paguan edhe foninë, edhe ekranin e protestës, ta shfrytëzojë....

(Deputetët flasin njëkohësisht.)

Milva Ekonomi – E kemi kërkuar ne me shumicë votash.

(Deputetët flasin njëkohësisht.)

Albana Vokshi – Zoti oficer, kryetari i bashkisë të dalë përjashta!

Erion Veliaj – Si PD-ja ka marrë zgjerim, të marrin zgjerim edhe ata, se po lëmë nam...

(Deputetët flasin njëkohësisht.)

Se ke parë botë me sy, se vjen nga jashtë. Mirë kjo që nuk ka parë teatër, por ti ke...

Albana Vokshi – Zoti oficer...

Erion Veliaj – Po të ishte historike, o është historike selia e partisë së parë pluraliste, ose s'ka histori tjetër...

Milva Ekonomi – Hidhe në votë rendin e ditës!

Albana Vokshi – Zotërinj oficerë, kryetarin e bashkisë nxirreni përjashta!

Erion Veliaj – Partia Demokratike, partia e babait të zonjës, vendosi dhe tha: po, mo, po ajo shtëpia është historike, por nuk do rrojmë në një kasolle, do të shkojmë në një më të madhe...

(Kryetaria dhe nënkryetaria e Komisionit replikojnë me njëra-tjetrën.)

PD-ja historike në shesh është, por do të shkojnë te SHQUP-i, se është më i madh...

Albana Vokshi – Kryetari i bashkisë të dalë përjashta!

Milva Ekonomi – Absolutisht jo, nuk mund të lëvizë kryetari i bashkisë nga vendi, sepse ne e kemi thirrur me shumicë votash. Kalandari miratohet me shumicë votash.

Erion Veliaj – Unë vij me njerzillëk....

Albana Vokshi – Dilni përjashta!

Milva Ekonomi – E keni gabim edhe interpretimin e Rregullores.

Albana Vokshi – Mbledhja nuk fillon. Kryetari i bashkisë të dalë përjashta...

Erion Veliaj – Nesër është çmimi. A të vij sot, meqë janë edhe vartësit sot?

Milva Ekonomi – Largohuni ju, po deshët, nga mbledhja, por jo kryetari i bashkisë!

Erion Veliaj – Tani është ok-ej të vijnë vartësit...

Albana Vokshi – Zoti oficer, ju lutem, kryetarin e bashkisë nxirreni përjashta!

Erion Veliaj – Kjo është fyese! Më ka ftuar 1/3 e komisionit.

Milva Ekonomi – E kemi thirrur ne, me shumicë votash.

Albana Vokshi – Milva, nuk e ke thirrur ti.

Milva Ekonomi – Ja ku është letra, me shumicë votash, i thirrur në këtë komision.

Albana Vokshi – Kryetari i bashkisë të dalë jashtë! Ai është i paftuar dhe po shkatërron mbledhjen.

Milva Ekonomi – Ja ku është letra e protokolluar.

Albana Vokshi – Zoti Veliaj, dilni përjashta!

Milva Ekonomi – Natyrisht, që nuk del dot përjashta, sepse maxhoranca e ka thirrur në mbledhje. Në zbatim të Rregullores, opozita nuk vendos dot kalendarin e mbledhjes.

Albana Vokshi – Milva, mos u bëni absurdë dhe qesharakë.

Milva Ekonomi – Rregullorja e ka të shprehur qartë: ju propozoni, me shumicë miratohet.

Albana Vokshi – Kryetari i bashkisë të dalë përjashta! Kjo mbledhje nuk vijon.

Milva Ekonomi – Me shumicë është miratuar që të jetë Erion Veliaj këtu.

Albana Vokshi – Nuk është. Ku e ke shumicën?

Milva Ekonomi – Ja ku i ke firmat. Këtu janë 11 firma dhe ju keni vetëm 6 firma. Nuk mashtroj.

(Kejdi Mehmetaj ndërhyr pa mikrofon.)

Ndërkohë, janë ftuar këtu për të bërë dëgjuesën.

Albana Vokshi – Ju lutem, nxirrni përjashta kryetarin e bashkisë.

Adelina Rista – Albana, dil ti përjashta, sepse kryetari...

Albana Vokshi – Adelina, mos e ngri zërin! Zbatoni Rregulloren!

Milva Ekonomi – Nuk mund të vazhdojë mbledhja kështu, me interpretimin e Rregullores sipas kryetarit.

Albana Vokshi – Milva, ulë zërin!

Milva Ekonomi – Nuk mund të vazhdojë mbledhja e komisionit me interpretime të vazhdueshme të kryetares për Rregulloren.

Albana Vokshi – Kryetari i bashkisë të dalë përjashta!

Milva Ekonomi – Rregulloja zbatohet edhe sipas vlerësimeve që na jep grupi i legjislacionit i parlamentit.

Albana Vokshi – Milva, po shkelni Rregulloren, po shkelni Kushtetutën, po shkelni ligjin.

Kryetari i bashkisë nuk mund të vijë këtu dhe të marrë mikrofonin sa herë të dojë.

Milva Ekonomi – Kryetari i bashkisë ka bërë gjest qytetar, që ka ardhur edhe kur nuk i takon, sepse nuk e ka detyrim paraqitjen në komisionin tonë.

(Zonja Mehmetaj ndërhyr pa mikrofon.)

...është në pronën e bashkisë. Ndërkohë...

Albana Vokshi – Unë e lashë të ulej, por ai nuk mund të prishë mbledhjen e komisionit.

Milva Ekonomi – Nuk po e prish mbledhjen e komisionit.

Albana Vokshi – E lashë të ulej, meqë erdhi, për ta respektuar. Ai nuk e rrëmben dot mikrofonin për t'i bërë reklamë bashkisë së tij. Nuk e merr dot mikrofonin. Meqenëse ai është i paftuar...

Milva Ekonomi – E kemi ftuar në kryetarin e bashkisë.

Albana Vokshi – Është i paftuar. Po prish mbledhjen. Mbyllet mbledhja derisa ta ikë kryetari.

Milva Ekonomi – Nuk mbyllet mbledhja. Rendi i ditës duhet të votohet. Hidhe në votë rendin e ditës.

Erion Veliaj – Pse ke frikë nga e vërteta? A më ftove?

Nesër hajde me mua të shohim se çfarë çmimi merr sheshi “Skënderbej”, sheshi që ju e sulmuat dhjetë vjet.

Milva Ekonomi – Vendos me shumicën e komisionit.

Albana Vokshi – Pesë minuta pushim derisa kryetari të largohet.

Erion Veliaj – Nesër hajde me mua dhe shiko se çfarë çmimi do të marrë sheshi “Skënderbej” dhe shiko si shpërblehet e gjithë politika juaj.

Milva Ekonomi – Hidh në votë rendin e ditës!

Albana Vokshi – Nuk i bën nder vetes, nuk i bën nder as Kryeministrit.

5 minuta pushim. Kamerat të dalin përjashta!

(Kërkohet largimi i kamerave, të cilat largohen gradualisht dhe mbledhja vijon pa prezencën e medias.)

(Mbledhja vijon me dyer të mbyllura)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.06.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Albana Vokshi – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me ministren e Kulturës, zonjën Mirela Kumbaro, për informacion dhe shpjegime të mëtejshme në lidhje me projektligjin “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt projektimin dhe realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar” me prezencën e një grupi artistësh *(me kërkesë të një grupi deputetësh)*

Marrin pjesë:

Albana Vokshi, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Nora Malaj, Kejdi Mehmetaj, Besnik Baraj (zëvendësues), Ilir Beqaj (zëvendësues), Anduel Xhindi (zëvendësues), Endri Hasa (zëvendësues) dhe deputetë të tjerë të grupit parlamentar të PD.

Mungojnë:

Ismet Beqiraj, Fatmir Velaj.

Të ftuar:

Mirela Kumbaro – Ministre e Kulturës,

Valbona Shujaku – Zëvendësministre e Kulturës,

Oltjon Muzaka – sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës,

Sofjan Jaupar – këshilltar Ligjor i Ministres së Kulturës,

Daniel Pirushi – këshilltare e Ministres së Kulturës,

Prezent: Kryetari i Bashkisë së Tiranës, z. Erion Veliaj.

(Vijon mbledhja me dyer të hapura)

Albana Vokshi – Erdhën kamerat dhe do të fillosh propagandën tënde!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Erion Veliaj – E ke bërë sistem antikulture.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mos i përdor aktorët! Po abuzon me aktorët si me këndin e lodrave.

Albana Vokshi – Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë, nëse ti e ke shndërruar bashkinë e Tiranës në institucionin më të shëmtuar, korruptiv, ku vendosin bizneset, që të mbyllin ty çështjet në prokurori, këtu vendos Kushtetuta.

Erion Veliaj – Bashkia e Tiranës merr çmime çdo javë. Bashkia e Tiranës vlerësohet më shumë...

Albana Vokshi – Garda, nxirrni përjashta kryetarin e bashkisë, sepse po shkatërron mbledhjen e komisionit parlamentar!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Nuk mund të dalë përjashta, sepse është këtu me firmat e njëmbëdhjetë anëtarëve të maxhorancës!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Kjo sallë i takon sovranit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Erion Veliaj – Keni ardhur tridhjetë deputetë për gjashtë vende.

Albana Vokshi – Do të të nxjerrim me zor përjashta!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Absolutisht që nuk del përjashta kryetari i bashkisë, se ka firmat e pozitës, firmat e maxhorancës.

Erion Veliaj – Nuk mund të bësh komision me gjashtë anëtarë dhe të sjellësh tridhjetë deputetë të PD-së.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Flamur Noka – E para e punës, zogu i Tiranës, dëgjo këtu!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zogu i Tiranës, dëgjo këtu!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Është shumica që e ka ftuar kryetarin në komision.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Flamur Noka – Zogu i Tiranës...

Luçiano Boçi – Flamur, të lutem, se e kam kërkuar unë fjalën!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E kam kërkuar qysh më parë.

Flamur Noka – Mirë, vazhdo!

Luçiano Boçi – Atëherë, kemi dy kërkesa: është kërkesa...

Albana Vokshi – Luçiano, pa dalë kryetari i bashkisë, nuk vazhdon mbledhja.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luçiano Boçi – Edhe një herë: kërkesa...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po mirë, pra, ta sqaroj pse duhet të dale! Këtë po sqaroj unë!

Albana Vokshi – Po, pra, por ia sqarua dhjetë herë dhe nuk e kupton Rregulloren, as Kushtetutën e as ligjin!

Luçiano Boçi – E para, është kërkesa jonë...

Milva Ekonomi – Kërkesa juaj nuk u votua dje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luçiano Boçi – Më lër të mbaroj, Milva!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Hidhe pra, kërkesën në votë! Pse nuk e hodhe dje kërkesën në votë?
Hidhe në votë kërkesën!

Luçiano Boçi – Të mbaroj.

Milva Ekonomi – Po, pra, po, të mbarosh. Hidhe në votë kërkesën për kalendar!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kejdi Mehmetaj – Milva, ka një Rregullore parlamenti. Lexoje!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po nuk e kupton ai Rregulloren!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luçiano Boçi – Kërkesa e parë ka qenë e jona, për të ardhur ministrja e Kulturës para kryetarit të bashkisë. Kësaj kërkesë nuk mund t'i bashkëngjitet... Në qoftë se grupi i PS-së...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Prit pra, ta sqaroj!

Ka kërkesë tjetër, kjo është kërkesa jonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

More, jeni në terezi? Është kërkesa jonë kjo! Si mund të ndërhyjni te kërkesa jonë? Ju keni kërkesë tjetër, i donit bashkë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Luçiano, të lutem!

Luçiano Boçi – Të mbaroj njëherë!

Albana Vokshi – Kërkoj të ndërhyjë Gramoz Ruçi. Kërkoj që Gramoz Ruçi të ndërhyjë urgjentisht, sepse garda është vënë në funksion të kryetarit të...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luçiano, të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk kuptojnë me sqarime.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, Gramoz Ruçi të ndërhyjë në mënyrë urgjente, për të zhbllokuar situatën. Unë do të bëj mbledhje komisioni. Garda, nxirreni kryetarin e bashkisë tani, urgjent!

Garda nuk mundet të vihet në shërbim të kryetarit të bashkisë. Kryetari i bashkisë të shkojë për procedim edhe për Ardit Gjoklajn. Do të shkosh edhe për këtë që po i bën qytetit të Tiranës, ju dhe kushdo tjetër.

Milva Ekonomi- Për procedurë?

Erion Veliaj – Do të shkoj për gjithçka. Siç kam fituar çdo betejë me ju, do të fitoj edhe betejën e Teatrit. Mbaje mend!

Albana Vokshi –Nesër hajdeni përsëri!

Erion Veliaj- Çdo gjë që e keni sulmuar, është bërë më e mirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Kryetari i Kuvendit duhet të ndërhyjë urgjentisht!

Erion Veliaj – Sa më shumë i sulmuat lodrat, aq më bukur dolën ato. Sa më shumë e sulmuat Pazarin, aq më i bukur doli ai. Sa më shumë e sulmuat sheshin, aq më i bukur doli ai. Sa më shumë e sulmuat bulevardin, aq më...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mos e kthe në antikulturë!

Albana Vokshi - Ju lutem, Garda të nxjerrë jashtë kryetarin e bashkisë, sepse është i paligjshëm, është i paftuar!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Noka!

Milva Ekonomi - I kemi thirrur në dëgjuesë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, ne dje e kemi vendosur të thirren sot të dy me shumicën e votave.

Albana Vokshi - Ju lutem!

Garda të nxjerrë kryetarin e bashkisë!

Milva Ekonomi- Jo, kjo nuk është e drejtë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne do të kërkojmë të mos jesh më kryetare e këtij komisioni, se nuk mund të bëhet ky komision në këtë formë. Është e papranueshme kjo mënyrë drejtimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kejdi Mehmetaj - Respektoni Rregulloren!

Lexoje, ja ku e ke!

Ju nuk mund të bëni me forcë kartoni çdo gjë!

Albana Vokshi - Kërkoj që Gramoz Ruçi të ndërhyjë në mënyrë urgjente!

Duhet të zhblokohet mbledhja e komisionit. Gramoz Ruçi, të ndërhyjë, të nxjerrë përjashta kryetarin e bashkisë!

Adelina Rista - Ti që drejton në këtë farë feje, e sjell gjendjen e komisionit kështu! Solle trimat e tu që të prekin njerëzit me dorë. Ky është komisioni që drejton ti, Komisioni për Edukimin dhe Kulturën! Ti e ke sjellë gjithmonë komisionin në këtë farë feje. Nxirri ti ata që duhet! Duhet të dalësh ti e para!

Albana Vokshi - Garda, të nxjerrë jashtë kryetarin e bashkisë!

Vilma Bello - Kryetare, nuk mund ta çosh mbledhjen deri në këtë pikë!

Albana Vokshi – Kam kërkuar ndërhyrjen e Gramoz Ruçit!

Vilma Bello - E ke provokuar situatën dhe e ke sjellë në këtë pikë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi - Ulu aty!

Vilma Bello - Kryetare, sistemoje mbledhjen, vëre në përgjegjshmëri, se po ju shikojnë të gjithë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Musa Ulqini- Ti nuk ke turp!

Albana Vokshi - Musa Ulqini, qetësohu, sepse paratë i fiton Erion Veliaj dhe Rama. Ti nuk fiton gjë. Ti vetëm nervat fiton! Lërimi ata të merren, mos u përzjeni ju! Ju mos u bëni palë! Mos u përziej te pazaret!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ulu!

Albana Vokshi – Musa, mbajti mend këto që the! Unë këtë do ta çoj në Këshillin për Legjislacionin.

Adelina Rista - Cilët janë ata që kërkojnë të dalë jashtë kryetari i bashkisë?

Albana Vokshi - Deputetë. Kanë frikë ta lenë vetëm ministren.

Adelina Rista - Kushdo që nuk do të dëgjojë kryetarin e bashkisë, të dalë jashtë.

Albana Vokshi - Garda, ju lutem, nxirrni përjashta dhunuesin e parlamentit, kryetarin e bashkisë, mashtguesin Erion Veliaj!

Ju lutem, nxirreni përjashta!

Adelina Rista - A ka mundësi të nxjerrësh jashtë të gjithë ata që nuk janë anëtarë të këtij komisionit dhe kanë krijuar këtë situatë?!

Albana Vokshi – Garda, ju lutem nxirrni jashtë personin që është..... me paratë drogës dhe bën të fortin në parlament.

Erion Veliaj këtu nuk e bën as Zotin, as pronarin! Jo, kjo është pronë e sovranit! Këtu vendos sovrani dhe Kushtetuta.

Milva Ekonomi - Hidhe në votim rendin e ditës!

Albana Vokshi – Ai të shkojë në bashkinë e tij. Nëse atje do të bëjë pronarin, le ta bëjë, jo këtu!

Nuk e hedh në votim rendin e ditës, pasi ai është i përcaktuar.

Milva Ekonomi - Nuk është i përcaktuar, sepse përcaktohet me shumicën e anëtarëve të komisionit.

Hidhe në votim rendin e ditës!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi - Garda, nxirrni jashtë kryetarin e bashkisë!

Milva Ekonomi- Të hidhet në votim rendi i ditës!

Albana Vokshi - Nxirrni përjashta kryetarin e bashkisë!

Kejdi Mehmetaj - Të mbarojë njëherë ministrja, pastaj të flasë Veliaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E propozova, por ju nuk më dëgjoni!

Albana Vokshi - Kryetari i bashkisë, dilni jashtë, që të vazhdojmë mbledhjen normalisht!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

I kam thënë 10 herë, por Garda është në shërbim të Erion Veliajt!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pse i sqaron?!Këta kanë marrë urdhër.

Garda, ju lutem nxirrni përjashta kryetarin e bashkisë! Përndryshe, do të kërkoj të merren masa për juve! E dëgjoni apo jo?!

Ju lutem, Garda, të nxjerrë përjashta kryetarin e bashkisë!

Adelina Rista - Kryetari i bashkisë nuk del jashtë!

Albana Vokshi- Kryetari i bashkisë do të dalë përjashta, sepse ka hyrë i paftuar, në mënyrë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në mënyrë të paligjshme.

Milva Ekonomi – Hidhe në votë!

Albana Vokshi – Këtu nuk e bën dot të fortin ai!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Le ta bëjë atje, me paratë e drogës, jo këtu! I shpëtoi një herë drejtësisë në rastin e Ardit Gjoklajt, por nuk ka për t'i shpëtuar më!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ai nuk e prish dot mbledhjen e komisionit parlamentar. As ai, as Edi Rama nuk e prishin dot mbledhjen!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Flamur....

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti kryetar, a mund të dilni, që të vazhdojmë mbledhjen?

Ju lutem, dilni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk po ju jap mikrofonin, por po ju them të dilni.

Erion Veliaj – Kjo historia me marrjen e forcave të gatshme ...

Albana Vokshi – Pastaj do të thërras komandantin e Gardës.

Erion Veliaj – Thirre!

Albana Vokshi – I lutem Gardës të kryejë detyrën!

Nxirrni përjashta kryetarin e bashkisë, sepse do të propozoj të merren masa për ju, që në vend të kujdeseni për mbarëvajtjen e mbledhjes së komisionit, po mbronin atë që ka hyrë në mënyrë të paligjshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Adelina Rista – Albana, e provokove situatën. Shiko se në ç'gjendje ju shohin të gjithë qytetarët!

I thuaj ta kthejë urdhrin!

Albana Vokshi – Garda të zbatojë ligjin!

Mos e merr në mbrojtje kryetarin e bashkisë, sepse ai po prish mbledhjen! Nxirrni përjashta kryetarin e bashkisë!

Zbatoni ligjin!

Milva Ekonomi – Ligji zbatohet sipas rendit të ditës. Të votohet rendi i ditës së mbledhjes së sotme!

Albana Vokshi – Të lutem, Milva, mos u përziej ti! Të dalë kryetari i bashkisë!

Vilma Bello – Kryetari nuk del përjashta, sepse ka ardhur me kërkesën e shumicës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Nëse doni ta shoqëroni Vilma, dilni dhe shoqërojeni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kryetari bashkisë nuk do të rrijë këtu!

Më vjen keq!

Ju lutem, Garda!

Vilma Bello – E tëra është përgjegjësia jote, kryetare e komisionit.

Albana Vokshi – Lëre Ervin!

Garda të zbatojë ligjin!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk e futa për këtë. Do të vazhdoja mbledhjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mos bërtit ti!

Lëre! A ke ndonjë pjesë te kullat, Ilir?

Po të kishe, hajde de!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Garda të zbatojë ligjin!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ai është i paftuar dhe i paligjshëm në këtë komision.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, zbatoni ligjin! Nxirrni jashtë kryetarin e bashkisë!

Milva Ekonomi – Votoni rendin e ditës! Maxhoranca e ka thirrur kryetarin e bashkisë. Të votohet rendi i ditës së mbledhjes së sotme!

Albana Vokshi – E kupton dhe vetë, që po flet absurditete!

Milva Ekonomi – Jo, s'e kuptoj!

Albana Vokshi – Ju lutem, mos u bëni palë, distancohuni!

Milva Ekonomi – Nuk po bëhemi palë.

Albana Vokshi – Është një llum i madh ky.

Milva Ekonomi – Po kërkoj të funksionojë siç duhet Komisioni për Edukimin dhe Medien. Ndërkohë, kalendari vendoset me shumicën e votave të komisionit.

Albana Vokshi – Endri, këta janë të ministrisë.

Garda të zbatojë ligjin!

Ju kam kërkuar të nxirrni jashtë kryetarin e bashkisë, sepse është i paftuar në këtë komision dhe ka ardhur qëllimisht, që të prishë mbledhjen e komisionit.

Ju lutem, nxirrni përjashta kryetarin e bashkisë!

A mund të dilni, zoti Kryetar? Nuk e dhunon dot parlamentin, sado para të drogës apo të bizneseve, apo të oligarkëve të marrësh! Mos u trimëro këtu, të lutem! Zbato ligjin!

Erion Veliaj – Hidhe në votë!

Albana Vokshi – Nuk hidhet në votë.

Erion Veliaj – Si të dalë vota, se 2/3 është më e madhe se 1/3!

Albana Vokshi – Nuk janë zgjedhje këto.

Erion Veliaj – 11-a është më e madhe se 6-a.

Albana Vokshi – A do të dalësh? Po nuk e kuptove ligjin, do të kuptosh forcën!

Erion Veliaj – A e kupton se kush ka frikë nga e vërteta?

Solle grupin e gatshëm, se nuk do të dëgjohet e vërteta.

Siç përdore lodrat, po përdor Teatrin.

Albana Vokshi – Ti nuk e kupton ligjin, sepse e shkel me arrogancë atë. Ti do ta kuptosh forcën dhe do të dalësh nga kjo mbledhje komisioni.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ti nuk e dhunon dot komisionin dhe parlamentin!

Ti mund të mashtrosh gjithë ditën te bashkia. Këtu nuk mashtron dot!

Erion Veliaj – Tirana bëhet më e bukur, sa më shumë ta sulmoni ju atë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sa më shumë i shkatërmoni projektet, më të mira dalin ato.

Albana Vokshi – Lini ministren të flasë, se ajo është ftuar në komision!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Erion Veliaj – Tirana bëhet më e bukur, falë urrejtjes suaj. Tirana bëhet më e bukur, sa më shumë ta sulmoni ju atë.

Sa më shumë i sulmoni projektet, aq më të mira dalin.

Ky është problemi juaj.

Albana Vokshi – Zoti kryetar, ju jeni dhunues i parlamentit. Ju lutem dilni!

Erion Veliaj – Kjo nuk zgjidhet duke sjellë grupin e gatshëm.

Antikultura është në Komisionin e Kulturës, ku ti sjell përforcime, sepse ke frikë nga e vërteta...

Më ke ftuar dhe nuk do ta dëgjosh të vërtetën.

Albana Vokshi – Garda të zbatojë ligjin!

Nxirreni jashtë kryetarin e bashkisë!

Erion Veliaj – Më ke sjellë ftesë dhe nuk do të dëgjosh të vërtetën. Edhe grupi i shumicës parlamentare më ka sjellë ftesë dhe ti nuk do ta dëgjosh të vërtetën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E fton tjetrin dhe nuk do të dëgjosh të vërtetën!

Dëgjoje, mos bjer dakord, por boll i përdorët aktorët!

Nuk i bëni dot mish për top aktorët ju!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nëse do të bësh aktoren, shko në audicion! Jo ta kthesh këtë dhe çdo gjë në teatër, se për ju kjo është lojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë e kam lidhur jetën me këtë qytet. Për ty Tirana është një lojë politike.

Albana Vokshi – Sot nuk mund të vish!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sot nuk ke të drejtë fjale.

Garda, nxirreni jashtë kryetarin e bashkisë!

Milva Ekonomi – Endriti të dalë jashtë, sepse ai po prish pronën publike!

Albana Vokshi – Sot nuk ke të drejtë fjale. Ke hyrë i paftuar dhe je i paligjshëm.

Vilma Bello – Albana, nuk mund të lejohesh të flasësh më në këtë situatë, ku e ke sjellë sot mbledhjen e komisionit. Turp!

Albana Vokshi – Rri, moj Vilma, dhe mos u bëj palë!

Vilma Bello – Nuk rri absolutisht! Shiko se në ç'situatë e ke sjellë komisionin!

Albana Vokshi – Lëri të zbatojnë ligjin!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vilma Bello – Anëtarët e grupit të PD-së janë thjesht dëgjues. Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik vendos me shumicë votash për rendin e ditës.

Albana Vokshi – Ju lutem, ju kam kërkuar të nxirrni jashtë kryetarin e bashkisë, që të vazhdojmë me ministren e Kulturës!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Garda, nxirrni jashtë kryetarin e bashkisë!

Zbatoni ligjin!

Milva Ekonomi – Kam 10 firma të anëtarëve të maxhorancës së komisionit, që janë më shumë se 6 firmat e anëtarëve të opozitës, për të qenë ai pjesë në këtë dëgjese.

Të lutem, kryetare!

Hidhni në votim rendin e ditës!

Albana Vokshi – Nuk e votoj rendin, se është i përcaktuar.

Milva Ekonomi – Nuk është i përcaktuar. Në bazë të nenit 36 të Rregullores së Kuvendit, rendi i ditës miratohet me shumicë votash.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pse anëtarët e Grupit parlamentar të PD-së vendosin si të sillemi në Komisionin e Medies? Ata janë thjesht dëgjues.

Albana Vokshi – Zoti kryetar i bashkisë, nuk e dhunon dot ti parlamentin! Nuk e kupton ligjin ti?! Vetëm dhunën kupton?!

Garda, nxirrni jashtë kryetarin e bashkisë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

More urdhër...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mirë bën! Nuk e dhunon dot ti parlamentin! Kuptoje!

Ligjin nuk e kupton, sepse ti kupton vetëm dhunën. Do ta kuptosh shumë mirë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ec, përjashta! More urdhër.

Ec, përjashta!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

(Largohet Kryetari i Bashkisë së Tiranës.)

Pse, kush e vendos këtë?

Ju e vendosni se kush vjen në komision?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, e vendos Rregullorja. Lëreni arrogancën me forcat e kartonit, se nuk ju ecën gjithandej! I ka lënë hapësira Kushtetuta dhe Rregullorja edhe opozitës. Ajo ka të drejtën e informimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva, mos e merr fjalën!

Pse keni frikë?

Milva Ekonomi – Jo, ne nuk kemi frikë!

Albana Vokshi – Ne kemi dëgjesën me ministren. Rrini!

Mos kini frikë!

Milva Ekonomi – Jo, ne nuk kemi fare frikë. Ti nuk votove rendin e ditës dhe ne nuk mund të rrimë, kur nuk na e dëgjon fjalën. Ti e prishe mbledhjen.

Albana Vokshi – Pse keni frikë?

Çfarë frike keni që ikni?

Po si bojkotohet mbledhja?!

Milva Ekonomi – Ti e prishe mbledhjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Po si bojkotohet mbledhja?! Turp!

Mos ikni, zonja Ministre!

(Largohet Ministria e Kulturës, znj. Mirela Kumbaro.)

Maxhorancë që bojkoton mbledhjen jeni vetëm ju...

Jeni maxhorancë e turpshme!

Milva Ekonomi – Sepse kemi një minorancë që nuk zbaton Rregulloren.

Albana Vokshi – Jeni të kapur nga oligarkët! Jeni të kapur nga bosët e drogës! Jeni një maxhorancë e turpshme, që bojkotoni komisionin parlamentar!

(Largohen deputetët e maxhorancës)

(Vijon pa kuorum)

